

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetar, Fillim Skoro e Have Haliti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Leonita Lajçi, si procesmbajtëse, në lëndën penale të akuzuarve K.H., nga fshati ..., Komuna e ..., A.Sh., nga fshati ..., Komuna e ... dhe L.Z., nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK dhe të akuzuarit A.Sh., edhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesat e mbrojtësve të akuzuarve K.H., av.G.R., A.Sh., av.Rr.G.1 dhe L.Z., av.N.Sh., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.264/2017, të dt.28.12.2017, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me dt.22.03.2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Aprovohen ankesat e mbrojtësve të akuzuarve K.H., A.Sh. dhe L.Z., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.264/2017, të dt.28.12.2017, lidhur me vendimin mbi dënimin dhe Gjykata e Apelit, të akuzuarit K.H., ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5(pesë)vitesh, e në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kalua në paraburgim prej dt.20.03.2017, e tutje, të akuzuarit A.Sh., ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5(pesë)vitesh, e në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.20.03.2017, e tutje, të akuzuarit L.Z., ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3(tri)vite e 6(gjashtë)muaj, e në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kalua në paraburgim prej dt.20.03.2017, deri me dt.28.12.2017.

II. Në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pa prekur.

III. Me rastin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit A.Sh., e sipas detyrës zyrtare ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.264/2017, të dt.28.12.2017, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe i akuzuari konformë nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP,

LIROHET NGA AKUZA

Se nga data e pa pavërtetuar armën e zjarrit të tipit të pa njohur e ka mbajtur në pronësi, në shkelje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armët,-

-me çka kishte me kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimor të Gjykatës Themelore-DKR Prishtinë, PKR.nr.264/2017, të dt.28.12.2017, të akuzuarit K.H., A.Sh., dhe L.Z., janë shpallur fajtor për veprën penale grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK ndërsa i akuzuari A.Sh., edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, më pastaj janë gjykuar i akuzuari K.H., për veprën penale nën pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)vitesh, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë, pas shpalljes së këtij aktgjykimi, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.20.03.2017, e tutje dhe me dënim me gjobë në shumë prej 1.500,00(njëmijepesëqind)Euro,

Të akuzuarin A.Sh., për veprën penale nën pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)vitesh dhe me dënim me gjobë në shumë prej 1.500,00(njëmijepesëqind)Euro, dhe për veprën penale nën pikën 2 të dispozitivit të aktgjykimit me dënim me gjobë në shumë prej 500(pesëqind)Euro, pastaj konformë nenit 80 par.2 pika 2.4 të KPRK, të akuzuarit A.Sh., i shqipton dënim unik me gjobë në shumë prej 2.000(dymijë)Euro.

Të akuzuarit L.Z., për veprën penale nën pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër)vite e 6(gjashtë)muaj dhe me dënim me gjobë në shumë prej 1.000,00(njëmijë)Euro.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë dënimin me gjobë, gjykata ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, duka ua llogaritur 1(një)ditë burgim, me 20Euro të gjobës, me kusht që afati i burgimit të mos i tejkalohet tri vjet, konformë nenit 46 par.3 të KPRK.

Janë detyrat të akuzuarit që ti paguajnë shpenzime te procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor, secili veç e veç, shumën prej nga 100Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit Rr.G. dhe R.G., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontest civil.

Të akuzuarve K.H. dhe A.Sh., iu është vazhduar paraburgimi derisa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar me këtë aktgjykim, ndërsa të akuzuarit L.Z. i është ndërprerë paraburgimi, konformë nenit 367 par.1 dhe të KPPK.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë kanë ushtruar ankesë:

-Mbrojtësi i të akuzuarit K.H., av.G.R., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovon ankesën si të bazuar, ta anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen ta kthej në rigjykim ose ta ndryshoj të njëjtin dhe të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 të KPRK dhe ta gjykoj sipas ligjit.

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.Sh., av.Rr.G.1, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovon ankesën si të bazuar dhe për të akuzuarin A.Sh., të bie aktgjykim lirues sepse nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

-Mbrojtësi i të akuzuarit L.Z., av.N.Sh., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovon ankesën si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin L.Z., për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallë fajtor, ta liroj nga akuza në mungesë të provave.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.100/2018, të dt.07.03.2018, duke u sqaruar përkitazi në ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve, ka propozuar që të refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve K.H., A.Sh. dhe L.Z., meqë nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të potencuara si në këto ankesa, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në pajtim me nenin 390 par.1 të KPP, caktoi seancën e kolegjit ku morën pjesë i akuzuari K.H., mbrojtësi i tij av.G.R., i akuzuari A.Sh., mbrojtësi i tij, av.Rr.G.1 dhe mbrojtësi i të akuzuarit L.Z., av.N.Sh., ndërsa nuk prezantuan Prokurori i Apelit, të dëmtuarit Rr.G. e R.G., të cilët janë njoftuar në mënyrë të rregullt për mbajtjen e seancës gjyqësore, ndërsa për të akuzuarin L.Z., mbrojtësi i tij, av.N.Sh., deklaroi se i mbrojturi i tij është njoftuar në mënyrë të rregullt për mbajtjen e seancës gjyqësore, por mungon për shkaqe shëndetësore sepse i njëjti është për shërim jashtë vendit, konkretisht në Austri.

Të gjithë mbrojtësit e të akuzuarve mbeten pranë pretendimeve të tyre ankimore, si dhe të akuzuarit mbështeten pretendimet e mbrojtësve.

Gjykata e Apelit, konformë dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, pasi që vlerësoj ankesat e mbrojtësve të akuzuarve K.H., A.Sh. e L.Z., e duke marrë parasysh edhe mendimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesat e mbrojtësve të akuzuarve K.H. dhe L.Z., janë të pabazuara, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.Sh., është pjesërisht e bazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.H., av.G.R.1, në ankesën e tij pretendon se dy automjetet e përdorura janë pronë e familjes së të akuzuarit Kastriot Hoti, të cilat i kanë shfrytëzuar i akuzuari K. dhe A., ndërsa automjetin "BMË", e ka shfrytëzuar i akuzuari K.H.. Lidhur me këto fakte vendimtare të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit gjykata nuk jep asnjë fakt vendimtar se me cilat prova është vërtetuar se automjeti "Opel Omega", është i familjes së K.H., e nga kjo del se dispozitivi i

aktgjykimit është në kundërthënie të plotë me vetveten dhe me arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare se të akuzuarit K.H., A.Sh. dhe L.Z., kanë vepruar në bashkëkryerje dhe kanë përdorur forcën për të përvetësuar pasurinë e të dëmtuarve. Ankesa pretendon se me rastin e identifikimit të personave ajo është bërë në kundërshtim me dispozitën e nenit 120 të KPP dhe se identifikimi është bërë përmes xhamave vizëllues. Nga fotoalbumi i policisë janë prezantuar fotografitë, ku shihen të parkuara dy automjete njëri i makrës “BMË”; tjetri i markës “OPel Omega”, dhe nuk shihen targat e regjistrimit. Sipas ankesës gjykata nuk ka vërtetuar gjendje faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për arsye se gjatë identifikimit të dëmtuarit R. dhe Rr.G., në të cilët mbështete aktgjykimi, sipas deklaratave të dëshmitarëve identifikimi i personave është për 90-95%, përkatësisht 70-80%, për të akuzuarit K. e A. Këto vlerësime të gjykatës së shkallës së parë, nuk janë bindëse, janë të dyshimta dhe në këto dëshmi nuk mund të mbështete aktgjykim. E sipas ankesës si pasojë e këtyre të shkeljeve të cekura më lartë, është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarve, për arsye se nuk është vërtetuar me asnjë provë se i akuzuari K.H., ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, ankesa pretendon se nëse gjykata gjen se veprimet e të akuzuarve ekzistojnë elementet e veprës penale, vendimi mbi dënimin është tejet i ashpër si pasojë e vlerësimit të gabuar të rrethanave rënduese dhe mos besimit të rrethanave lehtësuese të cilat shkojnë në favor të akuzuarit K.H..

Mbrojtësi i të akuzuarit A.Sh., av.Rr.G1, në ankesën e tij pretendon se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari Avdullah, ka kryer veprën penale, policia ka bërë bastisjen e tij, e cila gjendet në fshatin Kopilit i Poshtëm, ku gjatë bastisjes policia nuk ka gjetur para, as armë për të cilat akuzohet, por është konfiskuar vetëm një telefon “Nokia”, me sim kartelë. Të dëmtuarit kanë pasur shuma të ndryshme të parave prej 5000,5314, dhe 6.000Euro, pra, deklaratat e tyre kanë qenë kontradiktore, të pa sakta. Asnjë provë e cila është mbledhur nga Agjencia Kosovare e Forenzikës, nga vendi i ngjarjes, lidhur me këto prova të mbledhura si janë sprej proteste, një çekan të hekurt me bisht, stilograf i kuq, gjurma të vijave kapilare, për këto nuk kemi marrë asnjë provë.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.Z., av.N.Sh., në ankesën e tij pretendon se diapozitivi i aktgjykimit është i pa qartë, i pa kuptueshëm dhe në kundërthënie me arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare. Përshkrimi i aktgjykimit lidhur me të akuzuarin L.Z., nuk mund të qëndroj juridikisht sepse me asnjë provë relevante, formale apo materiale, nuk është vërtetuar qoftë dashja direkte apo eventuale në kryerjen e veprës penale, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor. Sipas aktgjykimit i akuzuari L.Z., me automjetin e tipit “BMË”, e ka përcjell lëvizjen e tipit “Fave CADY”, në të cilin automjetet kanë qenë të dëmtuarit R. dhe Rr.G., të cilët kanë bërë transportimin e parave. Nuk qëndron një konstatim i tillë sepse i akuzuari L., nuk posedon veturën “BMË”, por kjo sipas të akuzuarit K., është veturë e tij, dhe se ditën kritike është takuar me të akuzuarin L.

Gjykata e shkallës së parë, ka shkelur ligjin penal në dëm të akuzuarit, se me të gjitha rrethanat e rastiit vërtetojnë se në veprimet e tij nuk ka veprime inkriminuese. Sipas ankesës edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të dejtë dhe të plotë, ngase mbrojtjes e të akuzuarit L.Z., gjykata nuk i ka besuar dhe nuk ia ka falur besimin e plotë e cila mbrojtje është e logjikshme, bindëse dhe argumentuese. Kjo mbështet në deklaratat e të dëmtuarve Rr. e R.G. dhe të dëshmitarit L.M., të cilët në shqyrtimin gjyqësor kanë deklaruar se fare nuk i kanë parë të akuzuarin, i cili ditën kritike ka qenë në shtëpinë e tij. Edhe gjatë identifikimit të personave ata nuk kanë mundur ta identifikojnë të akuzuarin L.

Ankesa pretendon se aktgjykimi lidhur me vendimin mbi dënimin nuk është i drejtë dhe dënimi i shqiptuar në kohëzgjatje prej 4 vite e 6 muaj si dhe dënimi me gjobë nuk mund të qëndrojnë, duke marrë parasysh se kemi një mori të shkeljeve ligjore rreth gjendjes faktike dhe të aplikimit të jo të drejtë të ligjit penal, atëherë i akuzuari duhet të lirohet nga akuza.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin ankimor, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, vlerëson se aktgjykimi i ankimor nuk është përfshirë në shkeljet e esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo për arsye se gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje penale lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë drejt ka përfunduar se të akuzuarit janë kryes të veprës penale të grabitjes, nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 31 të KPRK.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi është i qatë, i kuptueshëm dhe në harmoni me veten, lidhur me faktet vendimtare dhe i njëjti është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 365 par.1 dhe nenit 370 të KPP. Nga shkresat e lëndës gjykata drejt ka vlerësuar se të akuzuarit K.H., A.Sh. dhe L.Z., kanë vepruar në grup, dhe të njëjtit kanë përdorë forcën me përdorimin e çekanit, e të cila veprime inkriminuese janë përshkruar në dispozitivin e aktgjykimimit e me lëvizjen e automjetit të tipit “Fawe CADY”, në të cilin kanë qenë të dëmtuarit R. dhe Rr.G, të cilët kanë bërë transportimin e parave, të cilat para i kanë mbledhur nga pikat shitëse të “Al Petrolit”, për ti dorëzuar në Raiffaisen Bankë, ashtu që automjeti me të cilin kanë lëvizur të dëmtuarit në dalje të nën kalimit të fshatit Henc, të akuzuarit K. dhe A., me veturën e tipit “Opel Omega karavan”, kanë bllokuar rrugën, ka dalë nga ana e të dëmtuarit R.G. dhe i kanosen, ia thyejnë xhamin e veturës, ndërsa i akuzuari K., ia thyen xhamin e automjetit me çekan nga ana e ngasësit të automjetit, e me të cilin e ka goditur në kokë të dëmtuarin R.G. dhe e marrin çantën dhe largohen, ndërsa në vendin e ngjarjes ka mbetur vetëm çekani. Se të akuzuarit kanë kryer veprën penale në marrëveshje paraprake dhe në grup mbështetet në deklaratat e të dëmtuarve R. G. dhe Rr.G., të cilët vërtetojnë në mënyrë të argumentuar se duke qenë duke vozitur veturën “Fawe Pikap”, dhe pas asaj kanë dëgjuar një zhurmë prapa veturës së tyre dhe vetura është goditur me çekan, pas një kohe janë thyer dy xhamat dhe i dëmtuari R.G., me çekan është goditur në kokë nga pjesa e pasme dhe në atë moment të akuzuarit me bërtim kanë kërkuar të hollat dhe e kanë marrë çantën ku ka qenë shuma prej 5.313,17Euro, dhe dëshmitari R.G., nga goditja me çekan ka pasur gjakderdhje në kokë, pastaj i është dhënë ndihma në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Fushë Kosovë. Kjo mbështetet edhe në deklaratën e dëshmitarit L.M., i cili deklaron se në auto larje në parking e tij është ndalë vetura “BMW” e të akuzuarit L.Z., i cili kinse ka pasur probleme teknike, se është duke i vluar uji, ku ka ndej aty rreth dhjetë minuta, e pastaj është larguar nga vendi i ngjarjes në drejtim të Pejës, për në fshatin Henc, dhe i akuzuari ka mbajtur kokën të kërysur dhe mbante një kapelë në kokë me strehë, e me qëllim që ta fsheh fytyrën, të cilin nuk e ka identifikuar në shqyrtimin gjyqësor, mirëpo, vet i akuzuari L.Z., pranon se ka qenë në auto parkingun e L.M. dhe në polici ka deklaruar se ka qenë në auto larje, te parkingu i autor larjes së L. M., e kjo mbështete edhe në deklaratën e të akuzuarit K.H., i cili deklaron se veturën “BMW”, pronë e familjes së tij, ia ka dhënë në shfrytëzim të akuzuarit L.Z., dhe gjykata nxjerr përfundim të drejtë se të akuzuarit kanë qenë në grup kanë përdor forcë ndaj të R. dhe Rr.G., i cili është goditur me çekan në kokë ku pasur gjakderdhje në, e të gjitha veprimet të akuzuarit kanë marrë në bashkëveprim me njëri tjetrin.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm dhe gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare të cilat janë cekur edhe më lartë, e kjo mbështet në atë se të akuzuarit kanë vepruar në grup, se kanë përdorur mjete të përshtatshme për shkaktimin e lëndimeve dhe kanë pasur marrëveshje paraprake për të kryer

veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor, e kjo mbështetet edhe në ekspertizën mjeko ligjore, se të dëmtuarit R. dhe Rr., të cilët kanë pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, e të shkaktuara nga mjete mekanik, që nënkupton se është përdorur çekani, e këto mbështeten nga lista e dëshmive, fotografitë ku shihen xhamat e thyera të veturës “Fawe Pikap”, e të gjitha këto fakte vërtetohen me pranimin e të akuzuarve të dhënë në procedurën parapenale.

Nga ajo që u tha më lartë pretendimet e paraqitura ankimore të mbrojtësve të akuzuarve se aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPP, nuk qëndrojnë.

Pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, është e pabazuar, nga shkresat e lëndës dhe nga provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, gjykata drejt ka vërtetuar se të akuzuarit K.H., A.Sh. dhe L.Z., kanë vepruar në grup, tre të akuzuarit K.H., A.Sh. dhe L.Z., se ata kanë përdorë forcën me përdorimin e çekanit, gjatë lëvizjes të automjetit të tipit “Fawe CADY”, në të cilin kanë qenë të dëmtuarit R. dhe Rr.G., të cilët kanë bërë transportimin e parave, të cilat para i kanë mbledhur nga pikat shitëse të “Al Petrolit”, për ti dorëzuar në “Raiffaisen Bank”. Gjkata drejtë ka vërtetuar se të dëmtuarit duke vozitur me automjetin me të cilin kanë lëvizur në dalje të nën kalimit të fshatit Henc, të akuzuarit Kastriot dhe Avdullah, me veturën e tipit “Opel Omega karvan”, kanë bllokuar rrugën, ka dalë nga ana e të dëmtuarit R.G. dhe i kanosen të dëmtuarve, ia thyejnë xhamin e veturës, ndërsa i akuzuari K., ia thyen xhamin e automjetit me çekan nga ana e ngasësit të automjetit, e me të cilin e ka goditur në kokë të dëmtuarit dhe e marrin çantën dhe largohen nga vendi i ngjarjes.

Gjkata drejt ka vërtetuar se të akuzuarit i kanë përcjellë të dëmtuarit gjatë transportit të hollave të cilat i kishin mbledhur në pikat shitëse të “Al Petroll”, dhe menjëherë kanë dëgjuar zhurmë prapa veturës dhe vetura është goditur me çekan dhe pas një kohe janë thyer xhamat dhe i dëmtuari R.G., është goditur me çekan në kokë, edhe i dëmtuari Rr., ka pësuar lëndime të lehta trupore, me mjete të rrezikshme e që mbështetet në ekspertizën mjeko ligjore, e të cilat lëndime janë të natyrës së lehtë trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjkata drejt ka vërtetuar gjendjen faktike se të akuzuarit në bashkëkryerje dhe në grup e duke përdorur mjete të përshtatshme-çekanin, duke iu kërcënuar të dëmtuarve R. dhe Rr.G., duke iu shkaktuar lëndime të lehta trupore, kanë marrë çantën ku ka qenë shuma prej 5.313,17Euro dhe me vetura janë larguar nga vendi i ngjarjes.

Pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve, se është shkelur ligji penal nga neni 385 par.1 të KPP, në dëm të akuzuarve, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate nuk qëndrojnë. Gjkata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar ligjin penal dhe drejt ka vërtetuar se të akuzuarit me dt.13.03.2017, në grup e me marrëveshje paraprake me njëri tjetrin, me përdorimin e forcës e me qëllim që vetit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, kanë përcjellë të dëmtuarit R. dhe Rr.G., të cilët kanë transportuar paratë e qarkullimit ditor të pikave shitëse “AL Petrol” dhe të akuzuarit kanë përdorë dy automjete, pronë e të akuzuarit K.H., automjetin e markës “Opel Omega”, karvan, ndërsa i akuzuari L.Z., automjetin e tipit “BMW”, kanë përcjellë lëvizjet e të dëmtuarve të cilët kanë qenë me veturën “Fawe Pikap”, dhe kur automjeti ka qenë lëvizur në dalje të nën kalimit të akuzuarit K. e A., kanë bllokuar rrugën, janë afruar automjetit në xhamat e pasagjerit të dëmtuarit R.G., ia kanë thyer xhamin e veturës me çekan metalik mjet i rrezikshëm, dhe të dëmtuarit R. dhe Rr., kanë pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar ligjin penal, e cila është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve lidhur me vendimin mbi dënimin, janë të bazuara, për arsye se gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjykata drejt ka vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit mbi dënimin e të cilat dënime të akuzuarve u janë zbutur nën minimumin e paraparë ligjor edhe pse të akuzuarit nuk kanë pranuar fajësinë, as që kanë negociuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, mirëpo, gjykata në kuadër të rrethanave lehtësuese, e të cilat drejt janë vlerësuar të akuzuarve ua ka zbutur dënimin, ashtu që dënimet iu janë shqiptuar sipas rregullave të përgjithshme për matjen e dënimit, të paraparë si në nenin 73 të KPRK, dhe gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së vendimit ka pasur parasysh rrethanat lidhur me kufijtë e zbutjes së dënimeve të paraparë në nenin 76 të KPRK, dhe në kuadër vlerësimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe peshën e veprës penale të akuzuarve, Gjykata e Apelit, ndryshoi vendimin mbi dënimin dhe të akuzuarit K. H., dënimi i shqiptuar me gjobë, merret si i vërtetuar, ndërsa ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5(pesë)vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej dt.20.03.2017 e tutje, të akuzuarit A.Sh., dënimi i shqiptuar me gjobë, merret si i vërtetuar, ndërsa ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5(pesë)vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej dt.20.03.2017 e tutje, ndërsa të akuzuarit L.Z., dënimi i shqiptuar me gjobë, merret si i vërtetuar, ndërsa ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3(tri)vite e 6(gjashtë)muaj, e në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kalua në paraburgim nga dt.20.03.2017, deri me dt.28.12.2017, e të cilat dënime janë në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe dënimet e këtilla të shqiptuar ndaj të akuzuarve do t'i shpërbej preventives individuale që të akuzuarit në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale të këtilla apo të ngjashme si dhe do t'i shërbej preventives së përgjithshme që këto dënime të shqiptuara edhe te të tjerët të ndikojnë që të mos kryejnë vepra penale, dhe me dënimet e shqiptuara pritet të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPRK.

Gjykata e Apelit, të akuzuarin A.Sh., duke vepruar sipas detyrës zyrtare, në pajtim me dispozitën e nenit 385 par.1 të KPP, e ka liruar nga akuza për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK konform nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP, për arsye se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari A.Sh., me datë të pa vërtetuar ka pasur armën e zjarrit të tipit të panjohur dhe ka mbajtur në pronësi, e në shkelje me ligjin e zbatueshëm mbi armët. Nga shkresat e lëndës dhe nga provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari A.Sh., ka pasur në posedim armën e zjarrit të tipit të panjohur, për arsye se mjete-arma e zjarrit e tipit të panjohur, fare nuk është gjetur, si mjet një mjet i kryerjes së veprës penale, përveç çekanit, e këtë nuk e ka nuk e ka pranuar edhe vet i akuzuari dhe nga provat të cilat janë prezantuar nga ana e prokurorit të shtetit, një gjë e tillë në asnjë provë nuk mund të vërtetohet dhe në mungesë të provave, gjykata e ndryshoi aktgjykimin për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, dhe të akuzuarin në pajtim me dispozitën e nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP, në mungesë të provave e liroi nga akuza.

Si u cek edhe më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në pajtim me nenin 401 par.1 dhe 403 par.1 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.103/2018, me dt.22.03.2018

Procesmbajtëse,

Leonita Lajçi

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Have Haliti

Kryetare e Kolegjit,

Tonka Berishaj